



## KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

### Procesverbal i mbajtur më 29 korrik 2024, në mbledhjen e XXVI-të (njëzetegjashtë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10;10

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë;

*(Naim Çunaku; Qëndrim Softolli; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Drita Pajaziti; Sebastina Vokri; Bashkim Syla; kurse mungoi Mrika Thaçi - lista e nënshkrimeve.*

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe; *Marigona Lahu Nënkrjetare e Komunës; Fatlum Osmani drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF dhe i Autorizuar për ushtrimin e punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe fushveprimtaria e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ; Adelina Stublla Drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS; Avni Fetahu Drejtor i Drejtorisë së Arsimit- DKA; Leutrim Krasniqi drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM.*

### Rendi i ditës

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit**, e hapi mbledhjen përshëndeti të pranishmit dhe konstatoi kuorumin, theksoi, për momenti në sall jemi 7 anëtarë, ndërsa për momentin mungon z.Mrika Thaçi dhe Qëndrim Softolli ku besoj që ndërkohë do të vijnë, rendi i ditës është fakt se është i ngarkuar ku ka shumë pika por besojë që janë disa pika që nuk na marrin kohë ku kryesisht kemi të bëjmë me dhënien e pronave në shfrytëzim, pra janë pika që kalohen më lehtë në qoftë se Drejtoritë përkatëse i kanë anëtarët nga shoqëria civile, pra kjo është sa i përket rendit të ditës, nëse dëshiron ndokush të marr fjalën lidhur me rendin e ditës urdhëroni.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF-së dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, theksoi, më lejoni që këtij rendi të ditës ti propozoj shtimin edhe të dy pikave të reja, arsyeja që këto dy pika nuk janë të paraqitura me kohë është për arsyeje se ka të bëjë me një vendim për shpallje në interes të përgjithshëm publik për disa prona të cilat janë nën menaxhimin e AKP-së, dhe në shkresën të cilën e kemi marr nga AKP pas dërgimit të materialit, na janë nevojitur edhe disa sqarime shtesë nga ana e AKP-së lidhur me identifikimin e këtyre pronave e që bëhet fjalë për disa prona që janë shumë të rëndësishme për Komunën e Podujevës e që në rast se nuk inkuadrohen në këtë seancë që të shpallen në interes publik, sepse muaji gusht mund të jetë muaj i pushimit për Kuvendin Komunal, kështu që ne mundemi të jemi vonë për shpallje në interes publik dhe AKP mund që t'i qet në shitje këto prona dhe rrjedhimisht bëhen prona të humbura për Komunën e Podujevës.

Besoj që edhe Zyra ligjore ju ka pajisur me propozim vendimin ku bëhet fjalë për dy prona që janë dy pompa të benzinës që kanë qenë të menaxhuar nga INA, pompa e benzinës që është në udhëkryqin te ish "Hotel Besiana" dhe pompa e benzinës te Fabrika e Armaturës, pastaj tjetër pronë është te objekti i vjetër përball Komunës së vjetër ku është planifikuar realizimin e projektit për Muzeun e Qytetit, mandej e kemi

edhe një pronë tjetër që është lokal i ish Ndërmarrjes “Ramiz Sadiku” këtu në rrugën e Gjykatës, pra është pronë në qendër të Podujevës ku vetëm objekti është pronë shoqërore ndërsa toka është pronë komunale ku duhet me domosdoshmëri të bëhet pronë komunale në mënyrë që të hap rrugë realizimit të projektit për një Park të vogël për atë lagje në atë pjesë, prandaj ju ftoj që të mbështetni këtë propozim vendim.

Ndërsa sa i përket pikës tjetër bëhet fjalë për një propozim vendim për transferim të një shume të buxhetit në vlerë 225,000.00 € nga kodi për ndërtimin e shkollës së mesme të kampusi i shkollave të mesme brenda programit të arsimit ku 150,000.00 € propozohen të transferohen për ndërtimin e shkollës së fshatit Shajkoc, dhe 75,000.00 € për renovimin e disa objekteve shkollore, andaj ju ftoj t’i përkrahni këto dy propozim vendime të hyjnë në rend të ditës në këtë mbledhje e pastaj të kalojnë në seancën e Kuvendit.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim propozimin e drejtorit parafolës, që këto dy pika të prezantuara të përfshihen në rend të ditës.

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se nga 8 anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa sa ishin prezent në sallë, me 5 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), mbështetet që rendi i ditës të plotësohet edhe me dy pika shtesë, dhe atë:*

- **Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik, pronat nën menaxhimin e AKP-së, me qëllim të realizimit të projekteve: Muzeu i Qytetit; Ndërtimi i banimit me kosto të përbalueshme; Objekt arsimor - Çerdhe; Ndërtimi i parkut.**
- **Propozim vendimi për transferin e buxhetit të Komunës për vitin 2024.**

**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, do të ishte më mirë që të gjitha pikat që i kemi për këtë vit t’i përfundojmë me këtë seancë në mënyrë që të mos bëhemi telashe më me këtë çështje, dhe përveç kësaj është jo serioze që vetëm një drejtor me qenë i pranishëm në një mbledhje ku trajtohen 22 pika, pra e shoh që nuk ju intereson as juve dhe e dimë sa mundet me qenë një mbledhje e ngarkuar me këto pika ku këtë e kemi shpreh si shqetësim edhe më herët, prandaj ne si Grup i LDK-së nuk marrim pjesë në vazhdim të kësaj mbledhje dhe ti diskutojmë më shumë.

*Lëshohet mbledhja nga anëtarët e KPF nga radhët e LDK-së.*

**z.Haki Rudari**, theksoi, sa përket pikave shtesë që u propozuan, ne si Grup i LVV i përkrahem sepse e shohim që janë në interes të qytetarëve, mirëpo sa i përket numrit të pikave të rendit të ditës me të vërtetë është numër i madh, unë i përcjell seancat e Kuvendit në shumë komuna tjera dhe janë maksimum 12 pika, por jo në këtë numër të madh të pikave në rend të ditës.

Çështje tjetër është se edhe unë pajtohem që nuk është zgjedhje kështu që të gjitha këto pika të jenë në rend të ditës kurse vetëm një drejtor prezent, është dashtë që të merret më seriozisht kjo çështje dhe për mua është e pa pranueshme, kur vjen materiali dhe nuk je në mbledhje të KPF-së kush do qoftë ai që e bënë këtë për mua është e pa pranueshme, nëse është i zënë apo ka ndonjë obligim tjetër duhet të lajmëroj dhe ne e mirëkuptojmë, këtë e kam thënë edhe kur kam qenë në opozitë e po e them edhe tani që jam në pozitë. Po e përsërisë, i sjellë pikat dhe nuk merr pjesë në mbledhjen e KPF-së, ardhja e Ekzekutivit është e obligueshme.

**z.Bashkim Syla**, theksoi, edhe unë mendojë që të paktën drejtoresha e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe drejtori i Drejtorisë së Administratës është dashtë që të jetë këtu prezent sepse Komiteti për Politik dhe Financa është shumë i rëndësishëm dhe trajtohen shumë çështje këtu, pra shumë pyetje tona dhe diskutime kemi pas mundësi që t’i bëjmë këtu, prandaj sa i përket prezencës së drejtorëve edhe unë jam dakord sepse nuk është hera e parë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, të gjithë e dimë që drejtorët e Drejtorive është mirë të jenë të pranishëm në seancë të KPF-së sepse nuk është hera e parë që nuk vijnë, kjo mbledhje mbahet një herë në muaj dhe

është mirë që ata të jenë të pranishëm edhe në KPF edhe në mbledhje të Kuvendit, përndryshe kjo tregon që drejtorët para opozitës nuk janë serioz. Kështu që mund të vazhdojmë me këtë mbledhje, kuorum kemi e dimë që pika të rendit të ditës kemi shumë por nuk janë pika që kërkojnë shumë kohë sepse kryesisht këto pika kanë të bëjnë me dhënie në shfrytëzim të pronave e që është mirë t'i japim këto prona në mënyrë që t'iu mundësohet qytetarëve t'i marrin në shfrytëzim ku edhe Komuna pastaj ka përfitime nga kjo punë. Nëse nuk ka të tjerë të interesuar për të marr fjalën, atëherë e hedh në votim rendin e ditës së bashku me dy pikat shtesë të propozuara nga drejtori i DBF-së sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes dhe atij të prezantuar në fillim të mbledhjes.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 5 vota për nga anëtarët sa ishin prezent në sallë, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe dy pikat shtesë të përkrahura më sipër për përfshirje në rend të ditës krahas rendi të propozuar të ditës, dhe atë;*

- ***Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik, pronat nën menaxhimin e AKP-së, me qëllim të realizimit të projekteve: Muzeu i Qytetit; Ndërtimi i banimit me kosto të përbalueshme; Objekt arsimor - Çerdhe; Ndërtimi i parkut.***
- ***Propozim vendimi për transferin e buxhetit të Komunës për vitin 2024.***

## **1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtura më 27.06.2024**

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ka ndonjë vërejtje apo plotësim ndryshim lidhur me këtë procesverbal, nëse jo atëherë e hedh në votim.

*Pas votimit Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 5 vota Për, nga anëtarët e Komitetit sa ishin prezent në sallë, miratohet pa vërejtje apo plotësim ndryshime Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtura më 27.06.2024, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

## **2. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri-projekti “Furnizim me mekanizëm bujqësor”**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, theksoi, ky propozim vendim ka të bëjë me participimin e fermerëve që participojnë me 30% të vlerës së projektit ku participimi i këtyre fermerëve për këtë projekt duhet të kalojë në mbledhjen e Kuvendit Komunal në mënyrë që të realizohet projekti për furnizim me mekanizëm bujqësor të fermerëve nga ana e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se Njëzëri me 5 vota Për, nga anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në sallë, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

### **3. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim me mëshqerra”**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, theksoi, edhe për këtë pikë të rendit të ditës është e njëjta arsyeje si ajo paraprake, janë mjetet financiare nga participimi i fermerëve për projektin furnizim me mëshqerra dhe vlera financiare prej 30% të vlerës totale të projektit duhet të kaloj si vlerë buxhetore përmes Kuvendit Komunal.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, unë sa i përket kësaj pike të rendit të ditës jam kundër sepse do të ishte mirë të ishte prezentë këtu drejtoresha e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural sepse i kam disa pyetje për këtë pikë të rendit të ditës. Siç e dimë është zgjedhur lista preliminare e përfitueseve të mëshqerrave dhe ajo nga komisioni është vonuar afër 10 ditë, pastaj lista është ndryshuar kështu që do të doja t'i sqaroja disa gjëra para se ta votoj, kështu që unë jam kundër dhe listën e kam parë edhe vet ku ka shumë gabime e që mund ta marr vetëm një shembull ku janë dy bujq të një fshati njëri i ka të hyra 5.000€ kurse tjetri i ka 4 vajza dhe familjen e mban me këto punë, pra u heq ai që ka 4 vajza dhe jeton nga kjo punë, ndërsa ka përfituar ai që ka 5.000€ të hyra, prandaj e them se lista e përfituesve është e tmerrshme ka shumë gabime, andaj e ritheksoj që unë jam kundër këtij propozim vendimi.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se nga 5 anëtar sa ishin prezent në sallë, me 4 vota Për, 1 votë Kundër, asnjë votë e Përmbajtur, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

### **4. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim me sera”**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, theksoi, edhe te ky propozim vendim është e njëjta arsyeja, pra bëhet fjalë për 30% të vlerës së projektit nga ana e participimit të fermerëve për këtë projekt.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, pasi që vetëm drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave është prezent në sallë, e kam një pyetje për të, sa kam informacion ky projekt është kryer por dua një sqarim nga ana e juaj se sa është vlera e një sere dhe a mund të bësh krahasim me atë të dy vite më parë sepse para dy viteve nuk ka qenë madhësia e njëjtë e kësaj sere, pra siç kam informacion është afër 400€ më shtrenjtë se serat që janë kontraktuar nga Komuna dy vite më parë, pra a keni ndonjë informacion për këtë çështje.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, theksoi, propozim vendimi të cilin e keni para vetës ka të bëjë me 30% të vlerës totale të projektit ku këtu kemi sera të dimensioneve të ndryshëm, shembull ka serë 5 ari, ka serë 50 m<sup>2</sup>, kjo serë e cila është 50 m<sup>2</sup> është me vlerë mbi 1.000€ dhe bëhet fjalë për participim prej 30% të vlerës së projektit.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, sa kam informacione unë nuk është e njëjtë sepse sera para dy viteve afërisht ka kushtuar 800€ ndërsa tani është mbi 1.000€, çmimi i hekurit nuk e di a është rritur tani apo ka qenë më lirë atëherë, por kryesorja është bërë për ata fermer.

**z.Haki Rudari**, theksoi, ne Grupi i LVV-së në parim i përkrahim të gjitha këto pika por në të njëjtën kohë kur është kërkuar nga opozita lista e ndarjes së subvencioneve unë kam thënë që është Rregullorja për ndarje të subvencioneve dhe tani dua të theksoi që në rast se nuk citohet Rregullorja unë do t'i bashkëngjitëm kërkesën që të vije lista e subvencioneve e pastaj të shqyrtohet, pra të gjithë ata që merren me këtë çështje sidomos Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural por edhe të tjerët që e zbatojnë atë, subvencionet të ndahen në bazë të Rregullores e cila përcakton qartë se kush është fitues, prandaj në këtë kontekst ne e përkrahim sepse është në interes të qytetarëve qoftë dhënie e serave qoftë mekanizma tjerë, por në të njëjtën kohë nuk duhet të keqpërdoret pastaj, qoftë aspekti i fshatrave apo lagjeve qoftë aspekti politik për arsyeje se kjo mbi të gjitha e dëmton subjektin, pra partin Lëvizja Vetëvendosje, sepse kjo është në pushtet dhe në këtë drejtim i kam vërejtjet e mia ngase dua të mbrojë partin që është në pushtet dhe njerëzit që janë në pushtet, por në të njëjtën kohë kërkoj që secili të ketë për bazë që për çdo ndarje të bazohet në Rregullore për arsyeje se ajo Rregullore është votuar në Kuvend e që po e ritheksoj se kur është kërkuar nga opozita që lista të vijë në Kuvend për shqyrtim unë kam thënë që është Rregullorja mbi të cilën bëhet shpërndarje e subvencioneve të ndryshme, pra çdo anashkalim i Rregullores për mua është e pa pranueshme.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se nga 5 anëtar sa ishin prezent në sallë, me 4 vota Për, 1 votë Kundër, asnjë votë e Përmbajtur, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

##### **5. Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik pronat e paluajtshme shoqërore “Mekanizmi” nën menaxhimin e AKP-së, dhe atë: Njësitë kadastrale 00244-2 dhe 00244-3 në Zonën Kadastrale Podujevë, për realizimin e projektit “Ndërtimi i objektit për Banim të Përballueshëm”.**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, theksoi, dihet që Kuvendi Komunal vetëm e ka përcaktuar pjesën se ku do të ndërtohet Objekti për banimin e përballueshëm, që është te tregu aktual, mirëpo brenda kësaj parcele prej afër 50 ari ka dalë që dy ngastrat kadastrale janë prona që figurojnë në kadastër si prona të AKP-së, andaj me qëllim të realizimit të projektit të cekur duhet që ato dy ngastrat kadastrale të shpronësohen nga ana e AKP-së.

**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, ne si Grup i LVV e përkrahim këtë propozim vendim dhe e rekomandojmë kuvendit për shqyrtim.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se Njëzëri me 5 vota Për, nga anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në sallë, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

## **6. Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A. në Podujevë**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, theksoi, në kuadër të propozim vendimit është edhe materiali dhe fleta poseduese si dhe kopja e planit se ku ndodhet kjo pronë, pra prona është në rrugën “Zahir Pajaziti“ në anën e djathtë pra në këtë pronë ka qenë e vendosur kompania “Pastrimi” andaj me qëllim të funksionalizimit të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko- Llapi” si ndërmarrje e re që është themeluar ku momentalisht është në proces të furnizimit me mekanizëm dhe mjete të punës, pra kësaj ndërmarrje i nevojitet një pronë se ku ti vendos pajisjet të cilat i ka për mirëmbajtte të Qytetit të Podujevës dhe Komunës së Podujevës në përgjithësi, andaj ju ftoj që të mbështetni këtë propozim.

**znj.Sebastina Vokrri**, theksoi, ne Grupi i LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t’i rekomandohet Kuvendit shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se nga 5 anëtar sa ishin prezent në sallë, me 4 vota Për, asnjë votë Kundër, 1 votë të Përmbajtur, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

## **7. Raporti Financiar për periudhën janar - qershor 2024**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, theksoi, lidhur me raportin financiar për periudhën janar qershor 2024, materialin besoj që e keni marr të gjithë me kohë, sa i përket raportit e kemi obligim ligjor të raportojmë për gjashtë mujorin e parë të vitit 2024, andaj ju ftoj për diskutim në seancë.

**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, ne Grup i LVV-së e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës dhe e rekomandojmë për seancën e Kuvendit.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndonjë nga ju dëshiron fjalën nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që ti rekomandohet Kuvendit për diskutim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se Njëzëri me 5 vota Për, nga anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në sallë, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për diskutim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

## **8. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës për vitin 2023** - Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, theksoi, raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës për vitin 2023 si dhe Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit, ju është dërguar si material për diskutim në seancë dhe ju ftojë që ta mbështetni në mënyrë që të diskutojmë në mbledhjen e Kuvendit.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se Njëzëri me 5 vota Për, nga anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në sallë, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për diskutim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

## **9. Propozim vendimi për shfuqizimin e vendimit nr.prot.01-016/01-0045377/23 për miratimin e Planit të Integritetit 2023-2027 në Komunën e Podujevës**

**znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës**, theksoi, nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit kemi marr udhëzime për shfuqizimin e vendimit për miratimin e Planit të Integritetit 2023-2027 në Komunën e Podujevës. Shfuqizimi i vendimit bëhet në kuptim të zbatimit të nenit 25 të Ligjit nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, vendimit nr.1476/2023 të datës 26.07.2023 për miratimin e metodologjisë për Planet e Integritetit në bazë të cilave miratimi i Planit të Integritetit është në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisë të Ekzekutivit të Komunës.

Siç jeni në dijeni më 03.07.2023 e kemi miratuar Planin e Integritetit në Komunën e Podujevës, mirëpo me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për Parandalimin e Korrupsionit tashmë ky plan është në kuadër të kompetencave të Ekzekutivit të Komunës, kështu që ne duhet të shfuqizojmë këtë vendim në Kuvend dhe pastaj të vazhdojmë me procedura të tjera.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo, e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se Njëzëri me 5 vota Për, nga anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në sallë, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

## **10. Propozim vendimi për inicimin e procedurave për hartimin e planit rregullues të hollësishëm në pjesën e poshtme të qendrës 2 lindje - blloku 1**

**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, Drejtoria e Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit propozon Planin Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme qendra 2 lindje-blloku 1 me qellim të përmasimit të kushteve dhe mirëqenies së qytetarëve në zonën përkatëse, zbatimin e PZHK-së dhe Hartës Zonale, dhe shfrytëzimin e tokës.

Duke theksuar se zona në fjalë përgjatë viteve të fundit nuk ka pasur zhvillim adekuat dhe pjesa e hekurudhës gjendet në këtë zonë po ashtu një pjesë e parkut të qytetit që është Parku i Paqes që është në këtë zonë për të cilën propozojmë që të hartojmë një Plan Rregullues të Hollësishëm e që të përcaktojmë një zhvillim më adekuat dhe që mirëqenia e qytetarëve të asaj zone të kthehet nga zhvillimi dhe përcaktimi i rrugëve por edhe i ndërtimeve të tjera në këtë zonë, andaj propozoj që t'i zhvillojmë procedurat për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për pjesën e poshtme të qendrës 2 lindje-blloku 1.

**znj.Sebastina Vokrri**, theksoi, ne Grup i LVV-së e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, e kam një pyetje për drejtorin e DPUMM lidhur me këtë Plan Rregullues të Hollësishëm, a nuk është i paraparë kjo pjesë në Hartën Zonale apo çka është problemi nëse mund të na shpjegosh këtë sepse drejtori përmendi ndërtimet kështu që mendoj që me siguri ky është një plan tjetër.

**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, theksoi, në koncept dokumentet e planifikimit hapësinor përcaktohen Plani Zhvillimor Komunal pastaj Harta Zonale dhe Planet Rregulluese të Hollësishme.

Planet Rregulluese të Hollësishme përcaktojnë në detaje format e organizimit brenda një zone apo hapësire të caktuar kurse Harta Zonale nuk i përcakton deri në detaje dhe si i tillë Plani Rregullues përcakton krijimin ose formimin e rrugëve të reja përgjatë parcelave private, prandaj si të tillë ne e shohim të nevojshëm për zonën në fjalë.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndonjëri nga ju dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se nga 5 anëtar sa ishin prezent në sallë, me 4 vota Për, asnjë votë Kundër, 1 votë të Përmbajtur, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

## **11. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-163-0, ZK Siboc i Epërm**

### **11.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim**

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, **tani e tutje në vazhdim kemi** të gjitha pikat që kanë të bëjnë dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, me përjashtim të 2 pikave të reja që hyrën në rend të ditës si pak shtesë dhe të cilat u renditen si të fundit në këtë rend të ditës.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, në fjalën hyrëse, theksoi, nga pika e 11 e rendit të ditës e cila është propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës njësia kadastrale P-163-0, ZK Siboc i Epërm deri te pika e 20 sipas rendit të ditës, janë prona të cilat janë në listën e veçantë për dhënien e pronave në shfrytëzim, ku të gjitha pronat janë për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër 10 vjeçar, kështu që ju ftoj që këto 10 pika të proceduara nga Drejtoria e Pronës



dhe Kadastrit dhe Gjeodezisë, t'i mbështetni për shqyrtim në Kuvend me qëllim të dhënies së tyre në shfrytëzim që është në interes publik për zhvillimin ekonomik të Komunës së Podujevës në mënyrë që këto prona të funksionalizohen dhe të mos mbeten të pa shfrytëzuara, ku edhe do të ketë ndikim ekonomik si dhe po ashtu do të ketë edhe rritje të të hyrave buxhetore në Komunës e Podujevës.

**z.Bashkim Sylaj**, theksoi, nuk e di sa është i informuar drejtori i DBF-së se a kanë aplikuar nga shoqëria civile në mënyrë që të mbulohen komisionet për këto propozime për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale, besoj që ka afat për aplikim deri nesër mirëpo nëse është mbyllur afati dhe nuk kanë aplikuar nga shoqëria civile, më lehta për ne do të ishte që t'i largojmë këto pika të rendit të ditës.

Përndryshe unë e përkrahi që t'i bashkojmë këto pika në një pikë të vetme.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, theksoi, si Drejtori e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë e kemi bërë thirrjen publike për konkurrimin e OJQ-ve që të bëhen pjesë e komisionit ndërsa afati është sot edhe nesër, kështu që nuk mundemi që sot ta bëjmë atë, por besoj që do të ketë pjesëmarrës nga shoqëria civile pastaj në bazë të ligjit që e parasheh që dy anëtarë nga Kuvendi Komunal, dy anëtar nga Ekzekutivi si dhe një nga shoqëria civile të krijohen këto komisione në mënyrë që pastaj të mund t'i ndjekim procedurat për dhënien e pronave përkatëse në shfrytëzim.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim që pikat e renditura nga 11 deri 20 sipas rendit të ditës, t'i rekomandohen Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, si në vijim:

**12. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-297-0, ZK Dobratin**

*12.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**13. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-337-1, ZK Dobratin**

*13.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**14. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-337-2, ZK Dobratin**

*14.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**15. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-336-0, ZK Dobratin**

*15.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**16. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-640-0, ZK Lupç i Poshtëm**

*16.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**17. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1392-0, ZK Dobërdol**

*17.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**18. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1378-0, ZK Dobërdol**

*18.1 Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**19. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1381-1, ZK Dobërdol**

*19.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

## **20. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1381-2, ZK Dobërdol**

*20.1 Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se Njësëri me 5 vota Për, nga anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në sallë, pikat renditura nga 11 deri në 20 sipas rendit të ditës, rekomandohen për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

## **21. Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik, pronat nën menaxhimin e AKP-së, me qëllim të realizimit të projekteve: Muzeu i Qytetit; Ndërtimi i banimit me kosto të përballueshme; Objekt arsimor – Çerdhe; Ndërtimi i parkut.**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, në fillim të mbledhjes kur e paraqita arsyeshmërinë u informuat se këto pika po inkuadrohen përmes Komitetit për Politik dhe Financa për shqyrtim dhe për rekomandim në mbledhjen e Kuvendit.

Zakonisht Agjencioni Kosovar i Privatizimit e ka një praktikë që para shpalljes për shitjen e pronave publike, i informon Komunitat në këtë rast Komunitën e Podujevës që këto prona do jenë në valët e shitjes, mirëpo për tu anuluar shitja e tyre neve si Komunitë na duhet që t'i shpallim në interes publik për realizimin e projekteve të caktuara gjë për të cilën në propozim vendim i kemi të paraqitura arsyeshmërit për katër prona që pse është mirë që këto prona nuk duhet të dërgohen në shitje nga AKP që të merren nga personat privat, mirëpo duhet të jenë prona publike me qëllim të realizimit të projekteve publike në këto prona publike. Pra në rast se Komunita e Podujevës këto prona nuk i shpall në interes publik dhe nuk e dërgon njoftimin në AKP, ato do të bëhen pjesë e shitjes së pronave në valët e privatizimit.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të prezantuar në këtë mbledhje.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se Njësëri me 5 vota Për, nga anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në sallë, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për përfshirje në kuadër të rendit të ditës dhe shqyrtimin e të njëjtës në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, sipas materialit përkatës të prezantuar në këtë mbledhje - bashkëngjitur konstatimeve (me renditje në pikën 21 të rendit të ditës).*

## **22. Propozim vendimi për transferin e buxhetit të Komunës për vitin 2024.**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, projekti për ndërtimin e shkollës së mesme te kampusi i shkollave mesme ka një vlerë të planifikuar buxhetore prej 1,000,000.00€ në këtë vit, ne së bashku me Drejtorinë e Arsimit e kemi parë të arsyeshme që një pjesë e vlerës së këtyre mjeteve financiare për këtë vit të transferohen për dy projekte të tjera.

Dihet që projekti për ndërtimin e shkollës në fshatin Shajkoc është projekt dy vjeçar ku për këtë vit kanë qenë të planifikuara vetëm 50,000.00€ ku në këtë shkollë punët kanë filluar dhe është e arsyeshme që për këtë projekt në këtë vit të transferohen 150,000.00€ në mënyrë që për vitin e ardhshëm financiarisht të përmbillet ky projekt.

Gjithashtu edhe shuma prej 75,000.00€ janë mjete financiare që propozohen të transferohen për renovimin e objekteve arsimore dhe nga projekti i cekur të transferohen 225,000.00€ për këto dy projekte.

Pra edhe ky propozim u inkuadrua përmes Komitetit për Politik dhe Financa për shkak të disa konsultimeve paraprake që kemi pasur me Ministrin e Financave e që nuk kemi pas mundësi të dërgojmë në afat të rregullt këtë propozim, mirëpo tani në Komitet për Politik dhe Financa propozojmë që të mbështetet ky propozim dhe të rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e Kuvendit.

**z.Bashkim Syla**, theksoi, më vie mirë që vërejtjet e auditorit të përgjithshëm për vitet 2023-2024 të paktën me një propozim ke filluar që të mos i përsëritësh i nderuar drejtor, dhe besojë që po të veprohej në forma tjera të ndryshme Auditori sërish do të bënte vërejte dhe Atë si të përsëritur, ashtu siç ka bërë në raportin e tyre për vitin 2023.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse dëshiron fjalën ndokush, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të prezantuar në këtë mbledhje.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit / KPF-së konstatoi se Njëzëri me 5 vota Për, nga anëtarët e KPF-së sa ishin prezent në sallë, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për përfshirje në kuadër të rendit të ditës dhe shqyrtimin e të njëjtës në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, sipas materialit përkatës të prezantuar në këtë mbledhje - bashkëngjitur konstatimeve, (me renditje në pikën 22 të rendit të ditës).*

*Kryesuesi i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 10:50**

**Procesverbalin e mbajti;**

**Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0049264/24**  
**Podujevë, 29 korrik 2024**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit**  
**Hilmi Hoxha**